



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Kompania e Sigurimeve SCARDIAN j.s.c.” të datës 10.11.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 07.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve të Komunës së Prishtinës dhe KPSH-së” me nr. të prokurimit 616-23-5923-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Kompania e Sigurimeve SCARDIAN j.s.c.” e datës 10.11.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 07.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve të Komunës së Prishtinës dhe KPSH-së” me nr. të prokurimit 616-23-5923-2-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik “Kompania e Sigurimeve SCARDIAN j.s.c.” si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Kompania e Sigurimeve SCARDIAN j.s.c.” (tutje “parashtruesi”) me datë 10.11.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 07.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve të Komunës së Prishtinës dhe KPSH-së” me nr. të prokurimit 616-23-5923-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Faqe 1 nga 5

Adresa: Rr. “UÇK” nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pretendimet kryesore të parashtruesit janë cituar si në vijim: “Duke u bazuar në vendimin tuaj të datës 07.11.2023, për shpalljen e fituesit të Kompanisë së Sigurimeve EUROSIG Sh.a në kuadër të tenderit me titull Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve të Komunës së Prishtinës dhe KPSH. Edhe përkundër faktit që Organi i Shqyrtues i Prokurimit Publik ka dhënë vendimin e tij duke e bazuar ankesën tonë të datës 21.08.2023, duke sqaruar me detaje arsyeshmërinë e ankesës sonë, ju si Autoritet kontraktues prap me të njëjtat parime shpallni një kompani tjetër si fitues të këtij tenderi, edhe përkundër faktit që Kompania e Sigurimeve EUROSIG sh.a. ka dhënë çmime që nuk janë në përputhje me dosjen e tenderit respektivisht me specifikimet teknike. Kërkojmë të marrim sqarime të detajuara në lidhje me bazën e këtij vendimi të Autoritetit Kontraktues, sidomos në lidhje me informacionin e dhënë në paragrafin e vendimit, i cili citon se Autoriteti Kontraktues është bazuar në sqarimet e marra nga BQK për të përcaktuar fituesin e tenderit. Ne kërkojmë të njohim përmbajtjen e këtyre sqarimeve dhe argumentet që kanë përdorur për të mbështetur vendimin e tyre. Për më tepër, kërkojmë që të na jepet informacioni i menjëhershëm lidhur me vlerësimin e ofertës tonë së Kompanisë së Sigurimeve SCARDIAN j.s.c. dhe arsyetimin përse ky vlerësim ka rezultuar në përzgjedhjen e Kompanisë së Sigurimeve EUROSIG sh.a., edhe pse kompania fituese nuk është bazuar në specifikimet teknike të dhëna në dosjen tuaj dhe ka ofruar çmime që nuk përputhen me specifikimet teknike. Kërkojmë të na caktoni kohën kur mund të vijmë në zyrat tuaja dhe të na shpalosni dhe shpjegoni te gjitha komunikimet dhe sqarimet e marrura nga BQK që ju kanë dhënë të drejtën që të shpallet fituese Kompania e Sigurimeve EUROSIG Sh.A”.

Së pari duhet potencuar se parashtruesi në kërkesën e tij për rishqyrtim nuk ka formuluar asnjë pretendim konkret për shkelje të ndonjë dispozite të LPP apo legjislacionit sekondar në fuqi. Në kërkesën për rishqyrtim parashtruesi fillimisht thotë se “përkundër faktit që OSHP ka dhënë vendimin e tij duke e bazuar ankesën tonë, ju si AK prap me të njëjtat parime shpallni një kompani tjetër si fitues të këtij tenderi”. Lidhur me këtë pjesë të kërkesës duhet cekur se OSHP në asnjë vendim nuk ka thënë se ne detyrimisht duhet të shpallim fitues parashtruesin “Scardian”. Në të kundërtën, procesi i rivlerësimit nuk do të ishte kuptim pasiqë do të vazhdohej direkt me nënshkrimin e kontratës dhe do të përfundonte aktiviteti i prokurimit. OSHP është organ mbikëqyrës i cili vepron sipas kompetencave të veta ligjore ndërsa përzgjedhja e fituesve të suksesshëm është detyrë dhe kompetencë e Autoriteteve Kontraktuese. Konkretisht, komisionet vlerësuese të cilat janë profesionale dhe objektive e bëjnë ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve si dhe rekomandojnë tenderuesin i cili ka përmbushur kriterin e dhënies. Në rastin konkret OSHP ka vendosur që aktivitetin e prokurimit t’u kthejë në rivlerësim si dhe ka specifikuar që gjatë fazës së rivlerësimit të merret parasysh mundësia për të kërkuar sqarime nga BQK lidhur me dispozitat e caktuara juridike në fuqi për sigurimin e automjeteve. Në anën tjetër Autoriteti Kontraktues e ka zbatuar në tërësi këtë vendim të OSHP pasi që ka vepruar saktësisht sikurse është kërkuar nga Paneli Shqyrtues. Rrjedhimisht pas rivlerësimit të pavarur, objektiv dhe profesional sipas LPP është arritur rezultati në fjalë.

Në pjesën e fundit të kërkesës për rishqyrtim parashtruesi thotë se “shpjegoni te gjitha komunikimet dhe sqarimet e marrura nga BQK që ju kanë dhënë të drejtën që të shpallet fituese Kompania e Sigurimeve EUROSIG Sh.A”. Kjo pjesë në kërkesën për rishqyrtim është shumë kundërthënëse dhe e pakuptimtë. Autoriteti Kontraktues është i pavarur në ushtrimin e

funksioneve dhe kompetencave të saj sipas LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi. Me fjalë të tjera Autoriteti Kontraktues të drejtën për të zhvilluar aktivitetin e prokurimit e nxjerr nga dispozitat ligjore në fuqi dhe jo nga BQK apo palët tjera të treta.

Sidoqoftë, me qëllim të shqyrtimit të plotë, të drejtë dhe sa më objektiv të pretendimeve ankimore të parashtruesit në mënyrën si janë formuluar ato, zyrtari përgjegjës i prokurimit përmes bartësit të aktivitetit të prokurimit ka kërkuar nga komisioni vlerësues që të ofroj sqarimet e nevojshme lidhur me pretendimet ankimore. Rrjedhimisht komisioni vlerësues me datë 21.11.2023 lidhur me kërkesën për rishqyrtim të parashtruesit ka ofruar sqarimet si në vijim: *“Ne si komision i caktuar ne aktivitetin e prokurimit Sigurimi i automjeteve te komunës së Prishtinës dhe KSH kemi zhvilluar tri takime ne zyrat e prokurimit, kemi dale ne teren dhe kemi bërë verifikim të çmimit të policave , kemi kërkuar sqarim nga BQK për çmimin e policave ,jemi takuar me përfaqësuesin juridik te kompanisë Scardian. Kemi analizuar ankesën e OE Scardian por edhe vendimin e OSHP dhe ne kemi parë se OE Scardian ka dhënë çmime qe nuk përputhen me specifikat e automjeteve , ky operator ka caktuar çmimin për policë te sigurimit duke u bazuar ne peshën maksimale te lejuar. Kriteret për caktimin e çmimit te policës janë kubikazha për automjete deri ne 3.5 ton , kurse për automjete mbi 3,5 ton kriter i caktimit te çmimit te policës së sigurimit TPL është pesha maksimale e ngarkesës (kjo i bie qe një automjet me peshë pa ngarkesë 10 ton dhe me peshë max te ngarkesës 5 ton çmimi i policës i caktohet për peshën 5 ton e jo për peshën e përgjithshme 15 ton ne rastin konkret). Një ilustrim për rastin do të elaborojm rastin e një automjeti me targa 112-127-02: Deri sa në përshkrimin teknik në dosjen e tenderit janë të dhënat për peshën maksimale të lejuar (18000). dhe për peshën pa ngarkesë (9600), llogaritja behët ashtu që nga pesha maksimale të lejueshme e zbresim peshën pa ngarkesë dhe na del pesha maksimale e ngarkesës që në rastin konkret është 8400 kg (18000-9600=8400 kg). Në rastin konkret OE Scardian ka caktuar çmim për peshën 18 000 kg që është në kundërshtim me rregullat e BQK-së, kurse operatorët tjera kanë ofertuar për çmimin për policën që ka bazë peshën 8400 kg. Andaj duke pare këtë lëshim qe ka bere OE Scardian e te cilin lëshim ata e pranojnë dhe mundohen te arsyetohen me faktin se ka pasur paqartësi ne përshkrimin teknik , e qe neve si komision nuk na bind një arsyetim si ky sepse OE Scardian ne asnjë mënyrë nuk guxon qe çmimin e policave ta cakton duke u bazuar me peshën maksimale te lejuar sepse siç e cekem me lart ky nuk është kriter për caktimin e çmimit te policave. Po ashtu ne kemi edhe polica te sigurimit të cilat janë valide dhe të cilat janë në përputhje me çmimin e dhënë nga OE Eurosing dhe Sigal Uniqa. Pas te gjitha këtij aktivitetesh ne si komision kemi ardhur ne përfundim se OE Eurosing ishte operatori i përgjegjshëm me çmimin me te ulet dhe si te tillë ne e kemi rekomanduar për lidhje te kontratës ne fjale”.*

Lidhur me sqarimet e kërkuara nga komisioni vlerësues prej BQK është gjetur se BQK ndër të tjera ka konstatuar se *“polica e sigurimit TPL Plus ofron mbulesë siguruese për dëmet që ju i shkaktoni të tjerëve në territorin e Republikës së Maqedonisë Veriore, Republikës së Serbisë dhe Malit të Zi. Polica vendore e sigurimit nga autopërgjegjësia paraqet bazën për policen TPL Plus llogaritet si 30% e polices vendore te MTPL. Për me shume detaje ne lidhje me TPL Plus ju lutem ti referoheni nenit 6 te udhëzimit te bashkangjitur (https://bqk-kos.org/repository/docs/korniza_ligjore/shqip/udhzimi%2003-2016.pdf)”.*

Sidoqoftë, nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij dhe nuk ka paraqitur fare argumente ose prova për të mbështetur kërkesën e tij për rishqyrtim. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë konstatimit të komisionit vlerësues ku thuhet se *“OE Scardian ka dhënë çmime që nuk përputhen me specifikat e automjeteve, ky operator ka caktuar çmimin për policë të sigurimit duke u bazuar në peshën maksimale të lejuar. Kriteret për caktimin e çmimit të policës janë kubikazha për automjete deri në 3.5 ton , kurse për automjete mbi 3,5 ton kriter i caktimit të çmimit të policës së sigurimit TPL është pesha maksimale e ngarkesës (kjo i bie që një automjet me peshë pa ngarkesë 10 ton dhe me peshë max të ngarkesës 5 ton çmimi i policës i caktohet për peshën 5 ton e jo për peshën e përgjithshme 15 ton në rastin konkret)”*. Ky konstatim si i tillë është në përputhje jo vetëm me vendimin e OSHP për të cilin aludon parashtruesi mirëpo edhe me sqarimet nga BQK ku thuhet se *“të gjithë siguruesit Jo-Jete janë të obliguar ti respektojnë tarifat e autopërgjegjësisë MTPL të aprovuara nga BQK të cilat janë të publikuara në webfaqen e BQK, apo në linkun: <https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fbqk-kos.org%2Frepository%2Fdocs%2F2019%2FTarifat-15112019.xlsx&wdOrigin=BROWSELINK>”*.

Nga sa u tha më sipër, zyrtari përgjegjës i prokurimit ka konfirmuar prandaj pajtohet plotësisht me konstatimin e komisionit vlerësues ku thuhet se: *“Sa për ilustrim automjeti me targa 112-127-02: deri sa në përshkrimin teknik në dosjen e tenderit janë të dhënat për peshën maksimale të lejuar (18000) dhe për peshën pa ngarkesë (9600), llogaritja bëhet ashtu që nga pesha maksimale të lejueshme e zbrësim peshën pa ngarkesë dhe na del pesha maksimale e ngarkesës që në rastin konkret është 8400 kg (18000-9600=8400 kg). Në rastin konkret OE Scardian ka caktuar çmim për peshën 18 000 kg që është në kundërshtim me rregullat e BQK-së, kurse operatorët tjera kanë ofertuar për çmimin për policën që ka bazë peshën 8400 kg. Andaj duke parë këtë lëshim që ka bere OE Scardian e te cilin lëshim ata e pranojnë dhe mundohen te arsyetohen me faktin se ka pasur paqartësi në përshkrimin teknik , e që neve si komision nuk na bind një arsyetim si ky sepse OE Scardian ne asnjë mënyrë nuk guxon që çmimin e policave ta cakton bazuar me peshën maksimale të lejuar sepse siç e cekem me lart ky nuk është kriter për caktimin e çmimit të policave”*.

Nga sa u tha më sipër as vet parashtruesi nuk e konteston që tenderuesi i rekomanduar është i përgjegjshëm në raport me kërkesat e dosjes së tenderit si dhe ka ofertuar me çmim shumë më të lirë se parashtruesi ku diferenca në çmimin e peshuar është mbi 27% përkatësisht 6,564.76 euro (tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me 17,739.04 euro ndërsa parashtruesi 24,303.80 euro).

Bazuar në të thënat më sipër, të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit janë shqyrtuar në mënyrën si janë formuluar ato. Megjithatë është gjetur se parashtruesi nuk ka arritur që prezantoj argumente apo prova të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 22.11.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtoj ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.